



Zgjedhjet Studentore 2018 - Njoftim publik për studentët

Bazuar në Rregulloren mbi Zgjedhjet Studentore, iu njoftojmë se me rastin e aplikimit Organizatat Studentorin duhet të paraqesin:

- Aplikacionin, i cili merret në Universitet, në zyrën numër 009.
- Licencën e regjistrimit në Ministrinë e Administratës Publike.
- Statutin e Organizatës Studentore.
- Formularin e deklaratave mbështetëse me nënshkrime. Formulari me të dhënat e studentëve që kanë mbështetur organizatën studentore duhet të plotësohet edhe në formë elektronike në excel. Formulari merret në zyrën numër 009.
- Përcaktimi i të adresuarit të autorizuar të Organizatës Studentore.

Në bazë të nenit 7 të Rregullores për Zgjedhjet Studentore përcaktohet:

“Të gjitha Organizatat Studentore të cilat janë të regjistruara në mënyrë të rregullt si shoqatë – asociacion, në Ministrinë e Administratës Publike, sipas ligjit në fuqi konsiderohen të regjistruara, ndërsa për themelimin e organizatave të reja, ato duhet të regjistrohen deri me 31.08.2018”.

Aplikimi për pjesëmarrje në Zgjedhjet Studentore bëhet më së voni deri me 31.08.2018.


Ju njoftojmë gjithashtu se listat e kandidatëve, në pajtim me Rregulloren mbi Zgjedhjet Studentore, mund të i dorëzoni deri me datën 30.08.2018 në zyrën numër 009. Formulari i listave mund të merret në të njejtën zyrë.

Sqarim shtesë lidhur me numrin e deklaratave mbështetëse për certifikim: Organizata Studentore që regjistrohet për herë të parë dhe që siguron së paku 100 nënshkrime të studentëve të UShAF, fiton të drejtën të radhitet në organizatë studentore konkurrenente për zgjedhjet studentore për Parlamentin Studentor.

Organizatat Studentore të cilat nominojnë kandidatët për anëtarë të Parlamentit Studentor, përveç formularit të nënshkruar duhet të kenë edhe deklaratat e nënshkruara për pranim të kandidaturave.

Njoftohen Organizatat Studentore, të cilat në zgjedhjet e mëparme kishin numër më të madh të votave të fituara se janë të obliguara që të sjellin nga një anëtarë për Komisionin Qendror Zgjedhor dhe nga një anëtar për Komisionin Zgjedhor për Studentë.

Driton SYLEJMANI


Kryesues i Këshillit Drejtues

